



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

**PLANI I RIMËKËMBJES FINANCIARE TË SEKTORIT TË
ENERGJISË**

25 Shkurt 2015

Tabela Përmbledhese

I.	PËRMBLEDHJE.....	3
II.	PARATHËNIE.....	4
III.	SITUATA AKTUALE E SEKTORIT TË ENERGJISË.....	6
IV.	OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË REFORMËS NË ENERGJI ELEKTRIKE	9
V.	ZBATIMI I VEPRIMEVE PARËSORE.....	10
VI.	VEPRIMET/ AKTIVITETET E PLANIT TË RIMËKËMBJES FINANCIARE.....	11
VI.	RISQET DHE PASIGURITË	18
VI.	PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIM	20

I. PËRMBLEDHJE

Qëllimi i këtij Plani të Rimëkëmbjes së Sektorit të Energjisë është i dyanshëm: i) të ofrojë një pamje të plotë dhe të detajuar të situatës financiare të sektorit të energjisë elektrike, shkaqet kryesore dhe mësimet e nxjerra deri tani; dhe ii) të propozojë një plan të rimëkëmbjes financiare shoqëruar me një plan veprimi për 5 vitet e ardhëshme.

Vlerësimi arrin në përfundimin se efekti i përgjithshëm financiar i veprimeve të ndërmarrë nga Qeveria deri më sot (sikurse paraqiten në Aneksin I dhe në mënyrë të përmbledhur në Fig. I më poshtë) tregon se kombinimi i masave të vazhdueshme dhe atyre që ndërmerren vetëm një herë është i kontrollueshëm në këtë periudhë kyçe nga sot deri në vitin 2017, pas të cilës sektori do të arrijë një fluks të parasë (cash) pozitiv dhe do të hyjë në një proces që do të çojë në një pozitë të shëndoshë financiare nëpërmjet:

Masave që kryhen në mënyrë të vazhdueshme të tilla si: përmirësimi i arkëtimit për faturimet, përpjekje për reduktimin e humbjeve, ristrukturimi i tarifave, racionalizimi i operacioneve të biznesit, veçanërisht në OSHEE, lëshimi i Garancive Qeveritare për Shpenzimet Kapitale (Capex) (në rend zbritës), ristrukturimi i kërkesave për kreditë tregtare afatshkurtra (overdraft) dhe forcimi i zbatimit të disipline së pagesave mes kompanive të sektorit¹ dhe nga institucionet shtetërore; dhe

Masave që merren për herë të parë të tilla si shuarje me kompensim të detyrimeve të institucioneve buxhetore dhe jo-buxhetore (netting-off), reforma në strukturën e modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, pastrimi i detyrimeve të prapambetura ndaj PPE/Ashta dhe injektive të mundshme në kapitalin e vet (equity) të OSHEE.

Ka rreziqe që duhet të menaxhohen, veçanërisht në tre aspekte: raporti i borxhit total me vlerën totale të aseteve (leva financiare), varësia nga ndryshueshmëria e motit dhe plani i zbatimit.

Duke marrë parasysh procesin premtues të rimëkëmbjes, të ndërmarrë me mbështetje të fortë politike, sistemi i energjisë elektrike përsëri mbetet shumë i dobët përkundrejt ndryshimeve të papritura. Si rrjedhojë, çdo Shpenzim Kapital (Capex) i ri duhet të shqyrtohet me kujdes dhe financimi duhet të përfshihet si kapital i vet (equity) mundësisht në OSHEE (dhe më tej të transmetohet tek KESH nëpërmjet reduktimit të detyrimeve të prapambetura) për të zgjeruar bazën e tij të kapitalit dhe për të evituar projeksionet negative të përgjithshme financiare për periudhën 2015-2017, si dhe për të reduktuar ndikimin negativ të efekteve financiare nga rritja e tejskajshme e raportit të borxhit total mbi totalin e aseteve (leva financiare) në një mjedis tejet të paqëndrueshëm.

Duke patur parasysh varësinë e sektorit energjitik nga kushtet metereologjike, Qeveria nëpërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë do të përgatisë një Strategji të Zbutjes së Riskut dhe mekanizmat për të trajtuar efektet e varësisë nga moti dhe reduktimin e impaktit financiar në rast të prurjeve hidrike nën mesataren. Plani që pritet të aprovohet nga Këshilli i Ministrave në fillim vitit 2016 do të përfshijë dhe një sigurim nga risku për ngjarje të paparashikuara të motit bazuar në

¹ Në të ardhmen e afërt, masat në vazhdim do të përfshijnë Ristrukturimin e Korporatës dhe masat për kursimet në kosto tek cdo kompani.

ekperiencën e rajoneve të ndryshme në botë. Mbështetja për këtë plan është përfshirë dhe në projektin e miratuar së fundmi me financim të Bankës Botërore.

Qeveria është e vetëdijshme se asnjë plan sado i mirë qoftë nuk mund të ketë sukses po nuk u zbatua siç duhet. Në këtë drejtim Qeveria propozon:

- a. të fuqizojë menaxhimin e OSHEE nëpërmjet një kontrate menaxhimi të bazuar në rezultate, sikurse është përshkruar dhe mbështetur nëpërmjet Projektit të Rimëkëmbjes së Energjisë të financuar nga Banka Botërore për të siguruar që kostot, përmirësimi i humbjeve dhe objektivat e arkëtimeve të monitorohen dhe të jenë të arritshme, gjë që përbën dhe kyçin e suksesit të planit të rimëkëmbjes;
- b. të ktheje në shoqëri të vërteta tregtare të pavarura kompanitë shtetërore dhe të përmirësojë mirëqeverisjen dhe menaxhimin duke:
 - fuqizuar përgjegjësinë e këshillave mbikëqyrës, në përputhje me përcaktimet e bëra në statute,
 - fuqizuar llogaridhënien e shoqërive,
 - përmirësuar transparencën dhe dialogun publik/privat,
 - përfshirë drejtorë të pavarur jo-ekzekutivë për të fuqizuar këshillat mbikëqyrës dhe ndihmuar të formulojnë politika dhe monitorojnë performancën e drejtimit sidomos në aspektin teknik dhe financiar;
 - përshtatur praktika tregtare (si psh. maksimizimin e vlerës së kapitalit) në përputhje me kuadrin rregullator.
- c. të kryejë ndarjen formale të operacioneve në OSHEE, duke veçuar funksionin e shpërndarjes (rrjeti shpërndarës) nga furnizimi, sikurse parashikohet në Ligjin e ri të Sektorit të Energjisë Elektrike dhe duke e transferuar Furnizuesin Publik me Shumice dhe ate me Pakicë së bashku me stafin, asetet dhe përgjegjësitë e lidhura me të, në këtë entitet të ri. Këto duhet të kryhen brënda periudhës 2015-2017 dhe sistemet tregtare të faturimit (billing) do të projektohen duke pasur parasysh këtë strukturë; dhe
- d. Përgatisë një OSHEE të strukturuar për të lejuar pjesëmarrjen e kapitalit privat sapo të rivendoset fitimi dhe bilancet financiare të jenë kthyer në gjendje të shëndoshe financiare, dhe të jetë vendosur një sistem të dhënash për të siguruar një veprimtari operacionale eficiente dhe transparente në sektor.

Kombinimi i këtyre masave tregtare, financiare dhe strukturore do të: a) kthente sistemin nga një rrezik financiar, në të qëndrueshëm në fund të vitit 2018; ii) sillte investime private në sektor në mënyrë konkurruese dhe të hapur; dhe iii) përmirësonte sigurinë e furnizimit me energji elektrike duke përfshirë dhe forma të tjerë nga gjenerimi i energjisë nëpërmjet gazit.

II. PARATHËNIE

Sektori elektroenergetik shqiptar funksionon si një sistem i ndërlidhur i aktiviteteve të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike. Kërkesa për energji plotësohet kryesisht nga kompanitë publike – aktivitetet e prodhimit kryhen nga Korporata Elektroenergetike Shqiptare (KESH); aktivitetet e rrjetit të transmetimit dhe operimit të tregut kryhen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), ndërsa aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë kryhen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ose OSHEE (ish- CEZ Shpërndarje).

Sektori është i monitoruar dhe pjesa më e madhe e tij e rregulluar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE).

Në Tetor të vitit 2014 Qeveria rimori përsëri 100 për qind të aksioneve të ish kompanisë “CEZ Shpërndarje” që i ishin dhënë përmes një procesi të privatizimit kompanisë çeke “CEZ as”.

Me qëllim fillimin e procesit të liberalizimit të tregut, në vitin 2011, të gjithë konsumatorëve jo-familjarë të furnizuar në linjën e tensionit të lartë 220 kV dhe 110kV, u detyruan të bëhen konsumatorë të kualifikuar dhe të zgjedhin furnizuesit e tyre, gjë që bëri që Shqipëria të ketë aktualisht gjashtë konsumatorë të kualifikuar të tensionit të lartë (TL) me konsum vjetor prej 700 GWh në vit (14 për qind e kërkesës së përgjithshme të energjisë elektrike), duke e çliruar KESH-in nga detyrimi për ti furnizuar ata me tarifa të rregulluara. Nga ana tjetër kapacitetet e disponueshme të gjenerimit të KESH u zvogëluan më 81 MW për shkak të privatizimit të Hidrocentraleve të Ulzës, Shkopetit, Bisticës 1,2 dhe Lanabregas.

Në modelin e tanishëm të tregut, struktura e KESH është përgjegjëse për sigurimin e plotësisht të kërkesës për energji në Shqipëri për tregun me tarifa të rregulluara (duke përjashtuar energjinë e nevojshme për të mbuluar humbjet në rrjetin e shpërndarjes). KESH si kompani prodhuese e energjisë përfshin brenda saj edhe strukturën autonome Furnizuesi Publik me Shumicë (FPSH). Roli i FPSH është të blejë së pari energjinë elektrike të prodhuar nga Prodhuesit e Hidrocentraleve të Vegjël të Energjisë (PVE) dhe Prodhuesve të Pavarur të Energjisë (PPE) nëpërmjet cmimeve feed-in (të aprovuar nga ERE) e të përcaktuara në Marrëveshjet për Blerjen e Energjisë, dhe të energjisë elektrike të prodhuar nga KESH me tarifën e rregulluara të miratuara nga ERE për aq sa është e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tregut të rregulluar; në rast se prodhimi i brendshëm nuk është i mjaftueshëm për mbulimin e kërkesës së tregut të rregulluar, FPSH/KESH ka detyrimin të blejë energji shtesë nga importi nga tregje të parregulluara.

Sipas rregullave në fuqi, është vendosur që FPSH të blejë së pari energjinë e prodhuar nga PVE/PPE, më tej nga KESH/Gen, dhe më tej për të plotësuar nevojat të importojë energji.

Çështjet kryesore të identifikuara në segmentin e sektorit të prodhimit

- KESH është një kompani prodhuese dhe përfshirja e FPSH në strukturën e saj krijon barrë shtesë në planin e saj financiar për shkak të kostove të paparashikueshme të importit, të cilat nuk reflektohen plotësisht dhe në mënyrë të qartë në çmimin e saj të shitjes së energjisë, apo tarifave arbitrare të imponuara si rezultat i konflikteve të vazhdueshme me CEZ Shpërndarje mes viteve 2011-2014;
- Përfshirja e detyrimit për të blerë prodhimin e PPE nuk është reflektuar plotësisht në tarifën e shitjes, për shkak të prodhimit të paparashikuar (prodhimi i energjisë së HEC-ve varet nga prurjet e lumenjve) dhe/ose pezullimit të vendimeve për shkak të konfliktit ligjor me CEZ Shpërndarje në vitet 2012-2014.
- Mungesa e marrëveshjeve të shërbimit midis enteve (KESH, OST, dhe OSHEE) dhe e procedurave të veçanta në aspektin e sigurimit të pagesave të faturuara, ka krijuar hendeqe të paparashikueshme financiare që nuk mbulojnë nga marrëveshje financiare me qeverinë.
- Mospagesat, ose pagesat e vonuara nga konsumatorët kanë bërë që OSHEE të mos jetë në gjendje të paguajë tërësisht KESH dhe OST, duke sjellë vonesa të pagesave ndaj palëve të treta.
- Mospagesa e faturave të energjisë ndaj KESH nga OSHEE për energjinë elektrike të konsumuar nga rrjeti për mbulimin e humbjeve të shpërndarjes.
- Për arsyet e sipërpërmendura KESH është detyruar të marrë hua nëpërmjet kredive afatshkurtra (overdraft) me një kosto të lartë.

- Pamundësia e KESH për të vepruar si një njësi tregtare (shitje dhe blerje me vëndet fqinjë), që ka kufizuar mundësinë e krijimit të fitimeve nga eksporti (KESH mund të shesë vetëm kur tregu i rregulluar nuk kërkon energji, apo në situata të prurjeve të jashtëzakonshme të ujit).
- Kushtet e paparashikueshmërisë atmosferike për vitet e ardhshme e kufizojnë KESH (furnizuesi i mundësisë së fundit) nga të qenit në gjendje të parashikojë saktësisht nevojat për import dhe për këtë arsye ta reflektojë atë në tarifën e cila miratohet nga ERE.

III. SITUATA AKTUALE E SEKTORIT TË ENERGJISË

Defiçiti fiskal i Shqipërisë u rrit në mënyrë të konsiderueshme në vitin 2013 me një përqindje të vlerësuar prej 6.2%. Defiçiti i saj fiskal arriti mesatarisht 3,4% në periudhën mes viteve 2005 – 2012, me përjashtim të viteve 2008 dhe 2009, ku ai u përkeqësua ndjeshëm. Borxhi publik është rritur që nga kriza e vitit 2008.

Qeveria e mëparshme akumuloi detyrime buxhetore të konsiderueshme. Përveç detyrimeve të prapambetura të lidhura me punët publike, kishte detyrime buxhetore të prapambetura që lidhen me shëndetësinë (kryesisht medikamente), arsimin, ujin, rimbursimin e TVSH-së, Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatës, faturat e energjisë elektrike dhe përfitimet sociale.

Stoku i detyrimeve të pashlyera u vlerësua në rreth 72.5 miliardë lekë (710 milionë US\$), ose 5,3% e GDP-së. Presioni fiskal u rrit më tej gjatë mungesës së prodhimit të energjisë në vitin 2012, gjë që e detyroi qeverinë të sigurojë mbështetje financiare për KESH në formën e garancive sovrane për importet e energjisë. Qeveria e re kuptoi ekzistencën e këtyre detyrimeve të pashlyera dhe së bashku me një Program të FMN, ka zbatuar një strategji të qartë të shlyerjes së këtyre detyrimeve qysh në fillim të vitit 2014.

Sektori energjetik u zhyt më tej në një krizë financiare për shkak të privatizimit të dështuar të kompanisë së shpërndarjes që zotërohej me 76% të aksioneve të saj nga ana e kompanisë Çeke “CEZ as”. Në Tetor 2014 situata u zgjidh përmes rimarrjes së aksioneve nga ana e kompanisë shtetërore “OSHEE”, e cila zoteron 100% të aksioneve.

Varësia nga reshjet si dhe furnizimi vetëm përmes hidrocentraleve të vendosura në kaskadën e lumit Drin në veri të vendit, shkakton paqëndrueshmëri në prodhimin e energjisë së furnizuar nga KESH. Kjo përbën një kërcënim në lidhje me parashikimin e importeve, duke sjellë kështu një rrezik për garantimin e furnizimit.

Aktualisht i gjithë prodhimi në vend varet nga hidrocentralet.

Një sektor energjie elektrike i varur nga paqëndrueshmëria e motit dhe me mungesë diversifikimi të prodhimit të tij.

Herë pas here nuk realizohet prodhimi i energjisë së parashikuar për shkak të luhatjeve të reshjeve, të cilat e pozicionojnë vendin në një situatë jo të favorshme për sigurimin e një furnizimi të besueshëm dhe të përballueshëm të energjisë, meqenëse ai ndikohet së tepërmi nga kushtet klimaterike rajonale. Sfidat e furnizimit me energji elektrike të Shqipërisë ndikohet më tej nga kufizimet e kapacitetit transmetues të brendshëm dhe të jashtëm të lidhur me rajonin, si dhe nga sasia e pamjaftueshme e energjisë në dispozicion për furnizimin dhe tregtim nga vëndet fqinjë. Kjo situatë, përballë ngjarjeve ekstreme klimaterike, ndikon negativisht jo vetëm në Shqipëri, por edhe tek fqinjët e saj, duke shkaktuar një efekt negativ.

Për shembull, KESH bëri një vlerësim të një rasti më të keq mbi skenarin për importet e energjisë së nevojshme për të mbuluar tregun e rregulluar në vitin 2014, e vlerësuar në atë kohë ekuivalente me 1200 GWh, ose rreth 100 milionë US\$. Në të vërtetë, KESH importoi 180 GWh (rreth 12 milionë US\$), gjatë vitit për shkak të përmirësimit të kushteve klimaterike duke filluar nga muaji Mars si dhe të një menaxhimi më të mirë të rezervës ujore në kaskadën e lumit Drin.

Një vështirësi tjetër me të cilën sektori po përballet sot, është detyrimi financiar ndaj energjisë së blerë nga PPE-të. Ky detyrim është akumuluar nga shtimi i sasisë së prodhuar nga HEC private me me shume se sasisa e planifikuar dhe me tarifa shume favorizuese blerjeje, shumë më të larta se cmimet e tregut të energjisë të miratuara nga ERE dhe me të cilën KESH, bleu energjinë nga PPE-të, në vlerën e 9,3 lekë/KWh (66,4 Euro/MWh) për periudhën 2012-2014. Vetëm për vitin 2014, kostoja e blerjes së energjisë elektrike nga SHPP/PPE, e pa mbuluar nga regjimi i tarifave FPSH/KESH, arriti në shumën rreth 2 miliardë lekë, e shkaktuar gjithashtu edhe nga mos ristrukturimi i tarifave nga ERE mes viteve 2012-2014², për shkak të konfliktit të vazhdueshëm ligjor me CEZ Shpërndarje.

Performanca nën optimalen-Mungesa e investimeve dhe menaxhimi i dobët nga ana e sektorit të shpërndarjes solli humbje të larta të energjisë, arkëtime më të ulëta dhe zvogëlim të kapitalit bazë të kompanisë shumë më tepër se sa ishte parashikuar në kohën e privatizimit.

Sektori i shpërndarjes përballet me një kombinim të sfidave që lidhen me energjinë e pafaturuar për shkak të mungesës së matësve, ose matësve të dëmtuar dhe vjedhjeve në sistem, si dhe me arkëtimet e pamjaftueshme për energjinë e faturuar nga familjet dhe bizneset (84% në vitin 2012), të cilat çuan në lindjen e problemeve financiare të ish-kompanisë private të shpërndarjes CEZ Shpërndarje. Tani Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përballet me vështirësi financiare dhe nuk është në gjendje të hyjë në tregjet e kapitalit për të kërkuar financime. Ndërsa vlera totale e kapitalit neto është më shumë se (-72) miliardë lekë.

Në kohën e privatizimit të rrjetit të shpërndarjes pritshmëria ishte që CEZ Shpërndarje do të zvogëlonte humbjet në 17% deri në vitin 2014 dhe do të investonte rreth 200 milion US\$ gjatë pesë viteve në sistemin e shpërndarjes. Privatizimi i kompanisë së shpërndarjes nuk funksionoi ashtu si pritej. Pranimi i nivelit të humbjeve dhe borxheve të këqija ndodhi më vonë sesa ishte parashikuar fillimisht dhe tarifave të shitjes me pakicë nuk u ristrukturuan në kohën e duhur. Arkëtimi i faturave nga institucionet buxhetore dhe jo-buxhetore nuk u përmirësua dhe kompania e shpërndarjes, e menaxhuar nga ish-CEZ Shpërndarje, dështoi në zvogëlimin e nivelit të humbjeve teknike dhe jo teknike.

Më 21 Janar 2013, ERE i hoqi licencën kompanisë “CEZ Shpërndarje” për shkak të mosrespektimit të detyrimeve të përcaktuara sipas kushteve të licencës dhe emëroi një administrator të përkohshëm publik për të drejtuar dhe administruar sistemin e shpërndarjes. Në këtë mënyrë, Qeveria mori përgjegjësinë - dhe në thelb rrezikun fiskal - për importet e energjisë të nevojshme për të kompensuar humbjet e energjisë. Si rezultat i kësaj, dhe në pamundësi për t’ju drejtuar bankave tregtare, për të importuar energji për mbulimin e humbjeve, KESH, si furnizues i mundësisë së fundit, mori kredi afatshkurtra nga bankat tregtare (overdraft) që në fund të vitit 2014 arritën në shumën e 36.26

²Në dhjetor 2014 ERE miratoi me vendim ristrukturimin e tarifave të vitit 2013 dhe 2014 për PPV në perputhje me metodologjinë që ishte në fuqi e përcaktuar nga VKM.

miliardë lekë (rreth 2.6% e GDP-së), prej të cilës 10.2 miliardë lekë nuk është i mbështetur me garanci sovrane. Interesi aktual i akumuluar mbi borxhin e njohur si hua afatshkurtër (overdraft) që KESH i pagoi bankave në vitin 2014 ishte 1.93 miliardë lekë.

Humbjet e energjisë u rritën në 51,1% në fund të vitit 2012 dhe me një mesatare vjetore 45% deri në fund të vitit 2013, ndërsa në vitin 2014 rezultuan me një përmirësim të rëndësishëm në më pak se 38%; shkalla e arkëtimit të faturave u ul nga 85% në vitin 2008, në 84,1% në vitin 2012, në 78,7% në vitin 2013, dhe u rrit deri në 84% në vitin 2014.

Duke pasur parasysh se ka pasur investime të pamjaftueshme kapitale nga ish-CEZ Shpërndarje dhe për shkak të mungesës së burimeve, Operatori i Shpërndarjes ka qenë në vështirësi për të importuar energji për të mbuluar humbjet, për të likuiduar detyrimet e prapambetura të tij ndaj kreditorëve tregtarë dhe për më tepër i pamundur të financojë një program të rëndësishëm për reduktimin e humbjeve. Kapitali i vet është negativ edhe pse borxhet që institucionet buxhetore dhe jo-buxhetore i detyrohen OSHEE janë pothuajse sa dyfishi i deficitit korrent të kompanisë.

Për shkak të fakteve të përmendura më lart, si dhe për faktin se sektori i energjisë është shumë i ndërvarur, çdo ndryshim në sistem jep menjëherë një efekt zinxhir nga një shoqëri në tjetrën. Duke marrë parasysh se OSHEE është e pamundur që të gjenerojë të ardhura të mjaftueshme për të paguar kostot e saj, i gjithë sektori i energjisë është i ndikuar negativisht.

OSHEE e ka të pamundur të paguajë në mënyrë të vazhdueshme KESH, OST dhe/ose tregtarët e energjisë.

KESH dhe OST, duke qenë se janë me aftësi paguese të dobët për shkak të rivlerësimit të aseteve (aktiveve), mbeten kompani me aftësi jo likuiduese për shkak të mungesës së një niveli të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të pagesave që duhen bërë nga OSHEE. Kjo situatë është bërë e paqëndrueshme dhe përbën një rrezik të veçantë për KESH, meqë ai nuk mund të realizojë pagesat e kësteve të kredisë, të blej energjisë elektrike nga PPE-të, dhe të importojë energjinë e nevojshme për të plotësuar kërkesat e brendshme të tregut të rregulluar.

Edhe pse u ndërtua termocentrali i Vlorës, kjo pasuri nuk është ende funksionale për shkak të problemeve të pazgjidhura teknike. Aktualisht KESH është në procesin e përzgjedhjes së konsulentit, i cili pritet t'i sigurojë atij një zgjidhje teknike për rregullimin e sistemit të ftohjes me ujë, si dhe kostot dhe afatin. Kur TEC të hyjë në funksionim në vitin 2018 (në rast se zgjidhja teknike e propozuar është ekonomikisht e shëndoshë dhe financiarisht e realizueshme), do të ketë kosto të larta të prodhimit të energjisë, pasi teknologjia e tij (CCGT) është projektuar për të punuar me karburante importi të shtrenjtë. Ky termocentral parashikohet të vihet në punë në të njëjtën kohë me përfundimin e projektit TAP dhe kjo linjë gazi do të mund të furnizojë TEC-in, i cili mund të punojë me kosto më të ulët. Ministria e Energjisë dhe Industrisë po negocion angazhimet financiare nga TAP-i për të lidhur termocentralin me tubacionin nga pika e tij e daljes në Fier.

Për shkak të vështirësive të bllokimeve të rrjetit që rrjedhin nga investimet e shtyra në rrjetin e transmetimit, OST-ja nuk mund të garantojë kapacitetin të besueshëm të transmisionit për importet në rast të emergjencave.

Prandaj ka një nevojë urgjente për të realizuar investimet me objektiv zvogëlimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, dhe për të zgjeruar dhe përmirësuar rrjetin e transmetimit të OST, për të realizuar një furnizim të sigurt me energji.

Një tjetër faktor që ndikon në sektor ka qenë paqartësia e rregullatorit dhe kapaciteti i pamjaftueshëm institucional dhe ish-qeverisja e dobët, të cilat kanë çuar në kontrollin e dobët të zbatimit të rregullave të tregut, mungesën e disiplinës së pagesës dhe zbatimit të kontratave tregtare, arkëtimet e ulëta, nivelet e papërshtatshme të tarifave, pavarësinë e pamjaftueshme të rregullatorit, bllokimet periodike në marrjen e vendimeve për shkak të zgjedhjeve, mungesën e një operatori të efektshëm të tregut (një funksion i OST) dhe të një kompanie të shpërndarjes të sektorit privat që nuk ishte në gjendje apo e gatshme për të ndërmarrë veprime dhe realizuar investimet e nevojshme për të reduktuar në mënyrë efektive humbjet teknike dhe jo teknike.

Duke pasur parasysh këto kushte, sektori nuk ka qenë në gjendje ta nxjerrë veten nga një “*modus operandi*” të menaxhimit të krizës, në një mënyrë të qëndrueshme operacionale.

Në këto kushte, Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) ka ofruar një kredi prej 150 milionë US\$ që do të disbursohet gjatë pesë viteve të ardhshme, të orientuara kryesisht në sistemin e shpërndarjes. Duke marrë parasysh nevojat e larta të sektorit të energjisë, vetë projekti i financuar nga IBRD-ja nuk është i mjaftueshëm për të trajtuar dhe zgjidhur të gjithë boshllëkun financiar të trashëguar dhe atë aktual, i cili kërkon masa të mëtejshme shtesë dhe një reformë të thellë për të kapërcyer problemet e sektorit të energjisë.

Kapaciteti i dobët institucional dhe pasiguritë e Rregullatorit - Mungesa e pavarësisë së strukturës së shkuar rregullatore dhe pavendosmërisë së ish-qeverisë, kanë kontribuar në krijimin e një klimë jomiqesore me ish sektorin e privatizuar të shpërndarjes, që në përgjithësi krijoi një shkallë të pasigurisë rregullatore, investime të kufizuara dhe mungesë të zbatimit të kontrollit të marrëveshjeve; kjo përfshiu mungesën e zbatimit të kontrollit të marrëveshjeve tregtare dhe miratimin e politikave tarifore të një tregu të lirë. Një situatë e tillë i përket të dyja palëve, ish-qeverisë dhe ish-operatorit të shpërndarjes, të cilët kanë përgjegjësinë për dështimin e menaxhimit të këtij sektori dhe sigurimin e furnizimit të sigurtë me energji elektrike.

IV. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË REFORMËS NË ENERGJI ELEKTRIKE

Objektivi i përgjithshëm i reformës së propozuar të sektorit të energjisë elektrike është të sjellë qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare të sektorit, me një fluks të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të parasë (cash flow), reduktimin e humbjeve të energjisë në nivelet e synuara, përmirësimin e arkëtimeve të energjisë së faturuar dhe zbatimin e pagesave të rregullta të faturuara midis shoqërive.

Objektivat specifike

1. Mbyllja e hendekut financiar që sektori i energjisë elektrike prodhon çdo vit, brënda 5 viteve të ardhshme dhe transformimi i sistemit të energjisë nga një sistem që gjeneron borxhe në një sistem të vetë-qëndrueshëm dhe me aftësi likuiduese.
2. Sigurimi i furnizimit të vazhdueshëm dhe të besueshëm të energjisë për të gjithë vendin pa ndërprerje të energjisë elektrike; përmirësimi i efikasitetit të sistemit të energjisë në sektorin e shpërndarjes duke zvogëluar humbjet dhe duke përmirësuar arkëtimet.

V. ZBATIMI I VEPRIMEVE PARËSORE³

Megjithese u bë hapja e një llogarie bankare për të ardhurat e bllokuara për garancinë "Escrow" për kontrollin e zbatimit të detyrimeve minimale kontraktuale, përfshirë transaksionet financiare dhe teknike midis kompanive, pritet që OSHEE të jetë në gjendje të mbulojë 100% të blerjeve të saj të energjisë brenda vendit (KESH+PPE) duke filluar nga viti 2016.

Shuma ekzistuese e kredisë (overdraft) prej rreth 36.26 miliardë lekësh që KESH ka marrë ndaj bankave të nivelit të dytë për blerjen e energjisë si "furnizues i mundësisë së fundit", funksion i përcaktuar nga Modeli i Tregut, do të ristrukturohet. Ministria e Financave është duke ofruar mbështetjen e kërkuar për këtë proces që në fazën fillestare.

Tarifat e reja të miratuara nga ERE që do të aplikohen nga ana e Operatorit të Shpërndarjes për 2015 janë si më poshtë:

Tarifat e shërbimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2015		
Niveli i Tensionit	Cmimi (lekë/kWh)	Cmimi Pik (lekë/kWh)
Konsumatorë në 35 kV	9.5	10.93
Konsumatorë në 20/10/6 kV	11	12.65
Furra buke dhe prodhim mielli në 20/10/6 kV	7.1	8.17
Konsumatorë në 0.4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.6	8.74
Familjare	9.5	
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashketa (ndriçim shkallë, pompë, ashensor)	9.5	
Tarife fikse e shërbimit për leximin "zero" (lekë/muaj)		200

Veprimet parësore që do të ndërmerren janë si më poshtë:

Subvencionimi drejtpërdrejt i klientëve në nevojë për diferencën e çmimit të ri në krahasim me çmimin e fashës deri 300 kWh. Sot vlerësohen të jenë maksimumi 214,000 konsumatorë në këtë kategori. Qeveria ka pranuar përgjegjësinë për të subvencionuar familjet në nevojë për çdo ndryshim në çmim për sasinë e 300 kWh. Ajo do të subvencionojë faturat e energjisë në një shumë 1.7 miliardë lekë në vitin 2015 dhe me tej do t'i përditësojë ato sipas ristrukturimit të tarifave të rregulluara.

Borxhet, të vlerësuara në më pak se 6.2 miliardë lekë deri në fund të vitit 2014 (përfshirë HEC-in e Ashtës), që FPSH i detyrohet PPE-ve do të paguhen brënda vitit 2015, duke shfrytëzuar brënda tremujorit të parë, rritjen e pagesave që OSHEE-ja do të bëjë ndaj KESH/FPSH-së për borxhet, pagesa të cilat po rriten së fundmi për shkak të masave të reja të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare dhe OSHEE si dhe nëpërmjet pagesave të detyrimeve që institucionet buxhetore dhe jo-buxhetore i detyrohen OSHEE për energjinë elektrike gjatë viteve.

³ Sipas Programit të Rimëkëmbjes së Sektorit të Energjisë të aprovuar në Nëntor 2014

Deri në fund të vitit 2019 arkëtimet do të realizohet në masën 95% nga pagesat e faturave të energjisë nga konsumatorët familjarë, jo-familjarë, institucionet dhe kompanitë publike. Duke filluar nga viti 2015 të gjitha pagesat e faturave të energjisë të institucionëve shtetërore të financuara nga Qeveria do të realizohen nga zbatimi i një sistemi me mekanizëm detyrimi.

Pagesa e të gjithë shumës së TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin, që në total arrin vlerën prej 210 milion US\$, që KESH, OSHEE dhe OST i kanë borxh buxhetit të shtetit, brënda vitit 2015. Do të merret në shqyrtim një rishikim i mundshëm i shumës së TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin, pasi shumata aktuale e TVSH-së dhe tatim fitimit është e lidhur me faturat e shitjes midis kompanive. Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe të tre kompanitë janë duke punuar me Ministrinë e Financave në mënyrë që të bëjnë një propozim ligjor për të sistemuar (net-off) këto detyrime dhe për të pastruar pasqyrat financiare. Ky proces është planifikuar të realizohet brenda tremujorit të parë të vitit 2015.

Reduktimi i humbjeve në sektorin e shpërndarjes, me një mesatare prej 5% ulje në çdo vit, nga niveli prej 37.6% që është aktualisht, në një nivel prej 14% deri në vitin 2019.

Rekomandimet e studimit që do të kryhet për zbutjen e efekteve të shkaktuara nga ndryshimet klimaterike që ndikojnë në kushtet hidrologjike të kaskadës së KESH-it, do të zbatohen përgjatë vitit 2015 dhe në vazhdim.

Sigurimi i furnizimit me energji do të përmirësohet duke diversifikuar portofolin e prodhimit, përmes fillimit të hyrjes në punë të TEC-it të Vlorës në rastet e emergjencave, dhe stimulimin e hidrocentraleve Rajonale të Furnizimit me Energji.

Miratimi i Ligjit të ri për Sektorin e Energjisë Elektrike si dhe finalizimi i Modelit të ri të Tregut, do të na lejojë të ulim rrezikun e KESH-it për shkak të ndikimit financiar që ai ka nga kushtet hidrologjike. Modeli i ri i Tregut duhet të miratohet dhe të zbatohet në mënyrë paralele dhe si pjesë përbërëse e Ligjit të ri për Sektorin e Energjisë Elektrike.

VI. VEPRIMET/ AKTIVITETET E PLANIT TE RIMËKEMBJES FINANCIARE

Është e qartë se ekziston një nevojë urgjente për të mobilizuar fonde për të:

- injektuar me shpejtësi likuiditete në sistem për të siguruar importet në kohë nga të dy kompanitë si KESH dhe OSHEE;
- pastruar pasqyrat financiare të sektorit, me qëllim rivendosjen e qëndrueshmërisë, likuiditetin operacional dhe kreditimin e pjesëmarrësve të tregut;
- rivendosur praktikata tregtare dhe marrëdhëniet me furnizuesit dhe huadhënësit për të mbështetur operacionet dhe për të ofruar një qasje në tregjet e brendshme financiare.

Plani i propozuar për Rimëkëmbjen Financiare të Sektorit të Energjisë përqendrohet në tre shtylla kryesore: rritjen e efektivitetit operacional, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe vendosjen e mekanizmave të kontrollit dhe drejtimit të kompanive, dhe qëndrueshmëri financiare, pa harruar dhe përmirësimet në infrastrukturë.

Adresimi i humbjeve të mëdha të energjisë dhe financimi i një deficiti agregat të projektuar me rreth 60 miliardë lekë është thelbësor dhe i vonuar. Kjo situatë është e paqëndrueshme dhe mund të përmirësohet vetëm me zbatimin urgjent të një programi të plotë veprimesh për një periudhë të gjatë kohore, duke përfshirë përmirësimin e arkëtimeve në mjete monetare, uljen e humbjeve, ekupe të forta dhe me përvojë menaxhuese në secilën ndërmarrje, ristrukturimin e tarifave të shitjes me pakicë në një nivel që pasqyron koston, si dhe rishikimin e modelit të tregut, për të lehtësuar migrimin progresiv të konsumatorëve të tensionit të mesëm nga tregu i rregulluar drejt një tregu energjie, i cili operon mbi parimet tregtare.

Zgjidhja e mosmarrëveshjes me kompaninë CEZ a.s. është finalizuar tashmë dhe pronësia e OSHEE i është kthyer Qeverisë Shqiptare në Tetor të vitit 2014. Kjo zgjidhje, përbën një progres pozitiv dhe një hap të madh drejt zbatimit të planit të hershëm të Bankës Botërore për Rimëkëmbjen dhe Reformat në Sektorin e Energjisë. Megjithatë, kjo përjashton mundësitë e dështimit në riorganizimin e sektorit dhe duke qenë se mungon një marrëveshje, Qeveria duhet të ulet të diskutojë me kreditorët për zgjatjen e kohës. Shqipëria është një vend që respekton (njeh) borxhin e saj dhe detyrimet kontraktuale. Duhet parë me kujdes ky detyrim.

Është e qartë që KESH i është ngarkuar barra e tarifave që nuk reflektonin kostot në të shkuarën për shkak të kolapsit të privatizimit të OSSH (tani OSHEE). Efektivisht KESH është përdorur për të financuar importet e kompanisë OSHEE që nga privatizimi i tij në vitin 2008. Pas rivlerësimit të aseteve të kompanisë në vitin 2009, u konstatua paaftësia e saj në pagesat e detyrimeve ndaj KESH. Kjo barrë çoi në vonesat e detyrimeve ndaj PPE-ve, taksave, TVSH-së, të sigurimeve shoqërore dhe detyrimeve të tjera ndaj Qeverisë Shqiptare, si edhe duke arritur në limitet maksimale të borxheve afatshkurtra (overdraft) të vendosura nga bankat e nivelit të dytë. Në fund të vitit 2014, u arrit limiti i marrjes së kredive afatshkurtra dhe u shteruan kapacitetet e kompanisë për të siguruar mbështetje të mëtejshme për sektorin, pa të cilat paraqitet një kërcënim serioz për sigurinë e furnizimit me energji dhe stabilitetin fiskal të vendit. Qeveria Shqiptare e ka identifikuar këtë rrezik dhe është e vendosur të aplikojë masa emergjente për ta kthyer këtë sektor dhe të gjithë sistemin energjetik drejt një sistemi me zhvillim të qëndrueshëm.

Për më tepër, OSHEE nuk është në gjendje të hyjë në tregjet e brendshme financiare për shkak të paaftësisë paguese të saj dhe, siç u përmend më sipër, mbijeton vetëm duke i kaluar detyrimet e saj KESH dhe Ministrisë së Financave, duke shtyrë pagesat e borxhit, pagesat për blerjen e energjisë nga KESH, TVSH-në, tatimin mbi të ardhurat si dhe sigurimet shoqërore. Me krijimin e një llogarie bankare (escrow), në pajtim me përcaktimet e marrëveshjes së Huasë me Bankën Botërore për Projektin e Rimëkëmbjes së Energjisë, paaftësia paguese e OSHEE-së ndaj KESH do të zvogëlohet ndjeshëm. Megjithatë, një analizë e detajuar, bazuar në Planet e Biznesit 2015 (i amenduar) për secilën prej kompanive, tregon se sektori mund të financohet brenda paketës ekzistuese të rënë dakord me FMN-në dhe të transformohet nëpërmjet ndërmarrjes së hapave agresive për të përmirësuar efikasitetin operacional, kapacitetin institucional dhe qëndrueshmërinë financiare.

Qeveria shfuqizoi strukturën e tarifave me dy fasha për konsumatorët familjare dhe vendosi një tarifë që pasqyron kostot për të gjithë kategoritë e konsumatorëve, duke filluar nga Janari i vitit 2015. Tarifa mesatare e ponderuar me pakicë u ristrukturua në një tarifë unike prej 9.5lekë/kWh, duke sjellë një përmirësim prej me 9.1% dhe tarifa mesatare nga 9,8 lekë / kWh u bë në 10,7 lekë / kWh, për shkak të rritjes së tarifës për konsumatorët jo-familjarë në masën 15 %. Gjithashtu, Qeveria mbështeti fuqishëm aksionet në terren për zbatimin e programit për reduktimin e vjedhjes së energjisë elektrike dhe përmirësimin e nivelit të arkëtimeve. Rezultatet deri tani janë inkurajuese, pasi janë reduktuar humbjet e energjisë elektrike në total nga 45% në 37.6 %, si dhe është rritur niveli i arkëtimeve nga 78% në 90%, duke përfshirë dhe arkëtimet e prapambetura gjatë vitit 2014.

Qeveria është e angazhuar tërësisht për të përmirësuar efikasitetin, kapacitetin institucional dhe qëndrueshmërinë financiare duke implementuar masat e rëndësishme të mëposhtme. Për të qenë efektive, të gjitha hapat e këtij plani veprimi duhet të trajtohen me të njëjtën rëndësi. Këto veprime përfshijnë:

- a. Përmirësimin e humbjeve jo-teknike dhe rritja e nivelit të arkëtimeve me mbështetjen e Projektit të Rimëkëmbjes së Energjisë. Arritja në kohën e duhur e objektivave operacionale të rena dakort (në përqindje) është çelësi i kthesës së sektorit të energjisë, duke minimizuar mbështetjen e kërkuar nga aksionerët, konsumatorët e energjisë dhe taksapaguesve;

	Humbjet Teknike (%)	Humbjet Jo- Teknike (%)	Niveli i Arkëtimeve (%)
2014	17	20.6	90
2015	21.04	10.76	91
2016	17	9	92
2017	15	6	93
2018	15	4	95
2019	13	2	95
2020	6	2	95

- b. Zbatimin në terma afat shkurtër dhe afatmesëm të Planit të Rimëkëmbjes Financiare, përfshirë ndër të tjera:

- Heqjen e sistemit me fashë dy tarifor dhe mbajtjen e një strukture tarifore me nivele me një mesatare të ponderuar prej 10.7/ kWh, të indeksuar me kostot operacionale dhe kursin e këmbimit, subjekt i rishikimit periodik. Grupet e prekuara nga ky ndryshim janë identifikuar dhe do të subvencionohen nga buxheti i shtetit përmes Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;
- Futjen e kufizimeve të një buxheti rreptësisht të kontrollueshëm dhe masave për kontrollin e kostove për të përmirësuar efikasitetin, produktivitetin dhe sigurimin e likujditeve të nevojshme veçanërisht gjatë katër viteve të ardhshme;
- Shlyerjen në dy faza të borxheve ndërmjet kompanive në vlerën e 4.4⁴ miliardë lekë / kWh dhe 8.0 miliardë lekë sipas marrëveshjeve respektive të DPL-së në vitin 2014 dhe 2015 në zbatim të VKM Nr. 126 dt. 11.02.2015, e cila konsideron si limit të sipërm 9.0 miliardë lekë;
- Shlyerjen e borxheve ndaj PPE-ve, brenda vitit 2015;
- Të gjitha institucionet buxhetore dhe jo-buxhetore pas kësaj do të jenë subjekte të mekanizmave të detyrimit brenda departamentit të thesarit për të siguruar pagesë në kohë për të gjitha faturat e energjisë së konsumuar;
- Rifinancimin/riprogramimin/ristrukturimin e borxhit të kushtueshëm kur është e mundur (sidomos shumave të tërhequra si overdraft) për të ulur shërbimin e borxhit të KESH-it dhe për të përmirësuar fluksin e parasë (cash flow);
- Shpenzimet kapitale do të shqyrtohen me kujdes nga ana e këshillave mbikëqyrës si dhe Ministria e linjës dhe do të kufizohen vetëm me zërat thelbësore që janë konsistente me sigurinë e sistemit, programin e dakortësuar të reduktimit të humbjeve dhe që sjellin të ardhurat me të mëdha në terma afat shkurtër;

⁴ Duke përfshirë Insitucionet buxhetore dhe jo-buxhetore.

- Miratimi i Ligjit të Energjisë Elektrike të paraqitur në parlament dhe së bashku me të Modeli i ri i Tregut të Energjisë i cili mundëson fillimin e liberalizimit të mëtejshëm të tregut, lirimin e KESH nga roli i FPSH dhe për pasojë krijimin e mundësisë për të tregtuar lirshëm energjinë shtesë përtej mbulimit të klientëve tarifor;
- Miratimi i amendimeve në ligjin për Energjitë e Rinovueshme dhe miratimi i Planit Kombëtar të Energjive të Rinovueshme i cili do të bëjë të mundur një planifikim të qartë të kapaciteteve të reja prodhuese, diversifikimin e burimeve si dhe kontrollin më të mirë të kostove të energjisë tashmë të mbuluara nga regjimi tarifor.
- Përcaktimi i tarifave të arsyeshme dhe në përputhje me nivelet tarifore të aprovuara nga ERE për prodhuesit e pavarur të energjisë, duke eliminuar krijimin e borxheve të reja si rezultat i furnizimit me energji elektrike përtej niveleve të miratuara në tarifë.⁵
- Miratimin nga ana e ERE-s të tarifave të aksesit në rrjet sipas nivelit të tensionit për të mundësuar daljen në treg të klienteve të lidhur në tension të mesëm 35/20/10/6 kV.
- Sigurimin e një raporti të borxhit me kapitalin e vet të OSHEE, të financuar nga buxheti qëndror e garantuar nga Ministria e Financave dhe e përdorur për të paguar borxhet e energjisë ndaj KESH dhe defiçitin e projektuar financiar të tij, deri në kufirin e hendekut negativ të projektuar të krijuar gjatë viteve 2015-2017 nga humbjet dhe arkëtimet; dhe
- KESH parashikohet të jetë në gjëndje të eksportoje energji gjatë disa viteve të ardhshme. Rrjedhimisht, Qeveria propozon që të mbajë të rezervuar shumën e 30 milionë US\$, pjesë e kredisë së Bankës Botërore të alokuar për importet e KESH, derisa të jetë hartuar programi i zbutjes së rrezikut të sigurisë të burimeve hidrike.

c. Mbajtjen e tarifave të përshtatshme që reflektojnë kostot për furnizimin, transmetimin, shpërndarjen dhe shitjen e energjisë. Duhet të theksohet se këto tarifa përfshijnë vetëm humbjet teknike dhe nuk pasqyrojnë humbjet jo teknike që janë rezultat i vjedhjes së energjisë nga një numër i madh konsumatorësh në kurriz të konsumatorëve të tjerë;

d. TEC i Vlorës do të ri-komisionohet në pritje të cmimeve më të ulëta të naftës bruto dhe/ose të furnizimit nga gazi i projektit TAP, duke e çuar në një strukturë me kosto të ndryshueshme me te ulet.

e. Përmirësimin e administrimit të kompanive, transparencës dhe pavarësisë së rregullatorit për të vepruar në interes të publikut dhe vetëm në interes të publikut; dhe

f. Reformimin e modelit të tregut dhe të kuadrit ligjor/rregullator për kalimin progresiv të konsumatorëve të Tensionit të Mesëm nga tregu i rregulluar⁶ në tregun e hapur të energjisë si dhe transferimin e strukturës së FPSH.

Impakti i përgjithshëm financiar i këtyre veprimeve paraqitet në Aneks I (a) dhe përmbledhet në Fig.1 më poshtë. Kjo tregon se kërkesat e huamarrjes janë të menaxhueshme prej periudhës aktuale deri në 2017, të llogaritura në 5.5, 5.2 dhe 3.7 miliardë lekë para se sektori të gjenerojë të ardhura pozitive dhe të fillojë rrugën e gjatë për tu shëndrruar në një sektor të shëndosh financiar.


Figura I tregon madhësinë dhe kohëzgjatjen e financimit shtesë që do të duhet në rastin kur a) Projekti i Rimëkëmbjes së Energjisë do të zbatohet sikurse është planifikuar dhe b) shpenzimet kapitale do të mbahen të kontrolluara (që do të thotë 60% e atij të propozuar në planin e biznesit) dhe c) kushtet klimaterike qëndrojnë në ose mbi nivelin e kushteve mesatare afatgjata.

Në këtë skenar, pritet që sektori të transformohet tërësisht gjatë katër viteve të ardhshme. Megjithatë, duket qartë se overdrafti për sektorin në tërësi do të rritet nga niveli aktual 36.26 miliardë lekë në

⁵ Këshilli i Ministrave me VKM nr.125, datë 11.2.2015, miratoi metodologjinë e përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, për vitin 2015, që do të paguhen prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike nga hidrocentralet, ndërkaq ERE me vendimin nr, 27, date 16.02.2015, përcaktoi tarifën për vitin 2015 për prodhuesit e pavarur të energjisë në vlerën 7.636 l/kwh.

⁶ Megjithatë kostoja e përfundimit të saj duhet të shqyrtohet me kujdes për arsye të subvencionit të qënësishëm të konsumatorëve familjarë nga konsumatorët tregtarë pas heqjes së tarifës me fashë.

47.3 miliardë lekë deri në fund të vitit 2017. Kjo kërkesë shtesë tejkalon gatishmërinë e bankave të brëndshme për të kredituar fonde shtesë dhe pa ndërhyrjet e propozuara më poshtë, sistemi duket qartësisht i paqëndrueshëm.



Qartësisht plani nuk është pa rrezik veçanërisht në lidhje me tre fusha të veçanta, të cilat përfshijnë: raporti i borxhit total me vlerën totale të aseteve (i levës financiare), varësia nga ndryshueshmëria e motit dhe plani i zbatimit.

Në skenarin e parë, duhet të theksohet se me de-kapitalizimin sistematik të sektorit, vlerësohet një raporti i lartë i levës financiare, siç tregohet edhe më poshtë në Tabelen financiare të konsoliduar me nr. I, (pa përfshirë OST). Raporti i borxhit ndaj kapitalizimit të kësaj madhësie jo vetëm që shkakton një pjesë të madhe të kostove të shërbimit të borxhit sipas kuadrit rregullator ekzistues, i cili bazohet në një normë kthimi prej vetëm 60%, por edhe përbën një rrezik për ndonjë kolaps (shok) financiar dhe së bashku me modelet e përkeqësimit të kushteve të disfavorshme të motit (në mungesë të ndonjë masë lehtësuese) garantojnë pothuajse mundësitë e përballjes me një krizë financiare brënda disa viteve të ardhshme. Çdo lloj financimi i ri duhet të paraqitet si një formë kapitali i vet dhe veçanërisht në OSHEE (dhe më tej të transmetohet tek KESH nëpërmjet reduktimit të detyrimeve të prapambetura) për të zgjeruar bazën e tij të pronësisë dhe evituar projeksionet negative financiare të agreguara për periudhën 2015-2017 dhe reduktimin e impaktit negativ nga rritja e tejskajshme e levës financiare në një mjedis tejet të paqëndrueshëm.

Tabela1: Leva Financiare e Agreguar (OSHEE)⁷.

⁷ Duke përfshirë transaksionet mes kompanive dhe përfshirë mbështetjen nga Qeveria për TVSH dhe pagesat për sigurimet shëndetsore dhe shoqërore

	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Borxhi – KESH	68,286	72,079	72,366	72,399	69,547	65,069
-OShEE	11,107	9,103	13,370	17,023	17,079	16,021
Totali i borxhit	79,370	81,200	85,736	89,776	86,536	81,090
Kapitali i vet- KESH	74,685	73,597	70,690	66,187	62,619	58,836
-OShEE	(74,002)	(71,372)	(71,134)	(65,625)	(55,767)	(43,418)
Totali i Kapitalit të Vet	683	2,224	(444)	558	6,852	15,418
Raporti Borxh/Kapitalizim (%)	99.1	97.3		99.4	92.7	84.0

Sipas skenarit të dytë, kërkesa për huamarrje e KESH dhe OSHEE do të rritet përtej overdraftit aktual, siç tregohet në dy kurbat e ndara kumulative në Fig. II dhe III më poshtë, e cila duket qartësisht e paqëndrueshme. Një vëmendje e vecantë do ti kushtohet rregullimit të transfertave ndërmjet kompanive, për të garantuar që të dy kompanitë të jenë të financuara në mënyrë te kenaqshme; pasi mund të ndodhe që OSHEE të kërkojë të reduktoj detyrimet e papaguara ndaj KESH në një periudhë shumë më të shkurtër nga ajo që është planifikuar aktualisht.

Fig. II Bilanci i projektuar i Overdraft-it KESH





Fig. III Kërkesa e Projektuar për Fonde OSHEE



Ajo që vihet re nga dy kurbat e paraqitura me sipër është se me anë të një disiplinë të fortë financiare dhe mbikëqyrje të fuqishme të komponentëve të planit të rimëkëmbjes financiare, KESH do të jenë në gjendje të:

- Mbetet brënda normave të kredisë ekzistuese dhe të fillojë të paguaj borxhin afatshkurtër që është akumuluar, në një periudhë shumë më të shkurtër nga ajo që është planifikuar, nga 2018 e tutje;
- Demonstron se sektori është financiar plotësisht dhe në përputhje me kushtin e bërjes efektiv të Projektit të Rimëkëmbjes së Energjisë; dhe
- Mbështesë tarifën e rregulluar në nivele të përballueshme për një periudhë të parashikueshme në të ardhmen. Duhet theksuar se këto llogaritje bazohen në kushte mesatare

klimate afat-gjata dhe për këtë arsye mbeten të varura ndaj kushteve të pafavorshme hidrologjike, në mungesë të një strategjie të shëndoshë të menaxhimit të rrezikut.

Projeksionet financiare të kompanisë, që dalin nga të dhënat e konsoliduara të paraqitura në Anex I (a-c) tregojnë se me përjashtim të vitit 2015, KESH do të plotësojë kushtin e marrëveshjes së kredisë për strukturën e shërbimit të borxhit dhe kapitalit.

Për me tepër KESH është në diskutime me bankat për të ristrukturuar pjesën kryesore të overdrafteve, duke i kthyer ato në kredi afat-mesme për të reduktuar më tej kostot e tij të kapitalit, përmirësuar kërkesat e shërbimit të borxhit dhe të plotësojë kushtin e marrëveshjes së kredisë për shërbimin e borxhit.

Sipas skenarit të tretë, Qeveria është e vetëdijshme se asnjë plan sado i mirë qoftë nuk mund të ketë sukses po nuk u zbatua siç duhet. Në këtë drejtim Qeveria propozon të:

- a. Përgatisë një strategji menaxhimi kosto efektive të riskut dhe mekanizmin për të trajtuar varësinë nga kushtet e motit si dhe të ulë impaktin potencial financiar të kushteve nën mesataren hidrologjike;
- b. Fuqizojë menaxhimin e OSHEE nëpërmjet një kontrate menaxhimi të bazuar në rezultate, sikurse është përshkruar dhe mbështetur nëpërmjet Projektit të Rimëkëmbjes së Energjisë të financuar nga Banka Botërore për të siguruar që kostot, përmirësimi i humbjeve dhe objektivat e arkëtimeve të monitorohen dhe të jenë të arritshme, gjë që përbën dhe kyçin e suksesit të planit të rimëkëmbjes;
- c. Ktheje në shoqëri të vërteta tregtare të pavarura kompanitë shtetërore dhe të përmirësojë mirëqeverisjen dhe menaxhimin duke:
 - fuqizuar përgjegjësinë e këshillave mbikëqyrës, në përputhje me përcaktimet e bëra në statute,
 - fuqizuar llogaridhënien e shoqërive,
 - përmirësuar transparencën dhe dialogun publik/privat,
 - përfshirë drejtorë të pavarur jo-ekzekutivë për të fuqizuar këshillat mbikëqyrës dhe ndihmuar të formulojnë politika dhe monitorojnë performancën e drejtimit sidomos në aspektin teknik dhe financiar;
 - përshtatur praktika tregtare (si psh. maksimizimin e vlerës së kapitalit) në përputhje me kuadrin rregullator.
- d. Kryejë ndarjen formale të operacioneve në OSHEE, duke veçuar funksionin e shpërndarjes (rrjeti shpërndarës) nga furnizimi, sikurse parashikohet në Ligjin e ri të Sektorit të Energjisë Elektrike dhe duke e transferuar Furnizuesin Publik me Shumice dhe ate me Pakicë së bashku me stafin, asetet dhe përgjegjësitë e lidhura me të, në këtë entitet të ri. Këto duhet të kryhen brënda periudhës 2015-2017 dhe sistemet tregtare të faturimit (billing) do të projektohen duke pasur parasysh këtë strukturë; dhe
- e. Përgatisë një OSHEE të strukturuar për të lejuar pjesëmarrjen e kapitalit privat sapo të rivendoset fitimi dhe bilancet financiare të jenë kthyer në gjendje të shëndoshe financiare, dhe të jetë vendosur një sistem të dhënash për të siguruar një veprimtari operacionale eficiente dhe transparente në sektor.

Më tej, një projekt i dytë në këtë sektor mund të jetë i nevojshëm në vitet e ardhshme për të përfunduar ristrukturimin financiar të sektorit dhe për të realizuar këto reforma sektoriale në një masë të plotë. Banka Botërore është e vendosur të koordinojë me bashkësinë ndërkombëtare dhe të mobilizojë burimet aty ku i nevojiten sektorit, brënda një periudhe të arsyeshme kohore dhe ta

vendosë atë në një bazë të qëndrueshme për të garantuar sigurinë e furnizimit. Përpjekjet për reforma serioze në sektorin e energjisë janë të nevojshme për të zvogëluar rreziqet për buxhetin, si dhe rritjen e krijuar nga reduktimi dhe ndërprerjet e energjise në të kaluarën.

VI. Risqet dhe Pasiguritë

Megjithatë ekzistojnë risqe të përgjithshme të zbatimit të planit. Nevojiten ndryshime në strukturën dhe legjislacionin e sektorit për të përmirësuar efikasitetin dhe për të shkuar drejt një tregu të parregulluar, te cilat përfshijnë:

1. *Cështjet Financiare.* Madhësia dhe synimi i financimit shtesë që duhet, varet nga kushtet hidrologjike mesatare, kurset e këmbimit dhe përqindjet e interesit global, të cilat janë në një masë të madhe jashtë kontrollit të Qeverisë.

2. *Rezistenca e publikut për të ndryshuar.* Ristrukturimi i tarifave, ndjekja penale e vjedhësve, dhe ushtrimi i kontrollit për detyrimin për të paguar nëpërmjet ndërprerjes së furnizimit mund të ndeshë në rezistencën e publikut ndaj iniciativave për përmirësim. Kjo do të merret në konsideratë me anë të fushatës së ndërgjegjësimit të publikut.

3. *Çështjet legjislative.* Ligji i ri për Sektorin e Energjisë Elektrike duhet të miratohet në mënyrë që të zbatohen disa nga reformat e parashikuara.

4. *Sistemi Gjyqësor(Gjykata).* Sistemi gjyqësor duhet të jetë i gatshëm të zbatojë dënimet për vjedhjen e energjisë elektrike.

5. *Prokurorët.* Prokurorët duhet të jenë më të vendosur në dërgimin në gjykata të vjedhësve të energjisë.

6. *Aftësia e OSHEE-së për të shkarkuar dhe cuar për ndjeke penale punonjësit e korrumpuar.* Menaxhimi duhet të ketë vullnetin për të shkarkuar dhe dërguar për ndjekje penale punonjësit që mundesojnë vjedhjen e energjisë elektrike apo keqmenaxhimin e parave të arkëtueshme. Nuk duhet të ushtrohet presion politik ndaj menaxhimit për të mbajtur punonjës të pandershëm. Gjykatat nuk duhet të përdoren si një mënyrë për punonjësit e shkarkuar për tu rikthyer në punë.

7. *Subvencionimi Social për Klientët në Nevojë.* A do financohet për vitet në vazhdim nga Buxheti i Qeverisë shuma prej 1.7 miliardë lekë si kompesim i energjisë elektrike të familjeve në nevojë?

8. *Reduktimi i çmimit të Kontratës për PPE-të.* Mundësia për të zbatuar reduktimin e çmimeve të diskutuara më parë mund të rezultojë në raste të vecanta në mosmarreveshje ligjore dhe vonesa.

9. *Kapacitetet Menaxhuese të Kompanisë së Shpërndarjes.* A do të ketë vullnetin dhe do të jetë në gjëndje menaxhimi aktual i OSHEE të zbatojë uljen e humbjeve dhe përmirësimin e nivelit të arkëtimeve, në mënyrë aq kërkuese sa e supozon parashikimi? Në vitin 2015 pritet që Kompania e kontraktuar për menaxhim të sigurojë praktika të shëndosha të menaxhimit dhe deri diku të izolojë kompaninë nga presioni nga jashtë saj.

10. *Reduktimi i Numrit të Konsumatorëve pa Matësa.* Është kritike që matësit e rinj të blihen dhe instalohen të sigurtë në një kohë sa më shpejt të jetë e mundur për të reduktuar humbjet jo-teknike.

11. *Rritja e Çmimeve për Njësitë Tregtare dhe Industriale*. Plani supozon qe konsumatorët e rrjetit 35kV dhe 10kV të lënë tarifat e rregulluara dhe të paguajnë çmimet bazuar në çmimet e importit. Kjo do të rezultojë në një rritje për disa konsumatorë duke i ekspozuar ata ndaj rreziqeve që do të paraqesin çmimet rajonale të energjisë në të ardhmen. A do të ushtrojnë ata presion politik për të mbetur si konsumatorët normal?

12. *Çmimet Rajonale të Energjisë*. Duke pasur parasysh faktin se Shqipëria duhet të importojë energji për të plotësuar nevojat hidrike, vendi është i ekspozuar ndaj rreziqeve të trashëguara të tregjeve rajonale të energjisë.

13. *Situata me TEC e Vlorës*. Parashikimi supozon që TEC-i Vlorës do të rehabilitohet dhe do të vihet në shërbim. Kjo do të varet nga çmimet e tregut botëror të karburantit, të cila janë deri diku përtej kontrollit të KESH-it.

14. *Borxhi i Konsumatorëve Buxhetorë*. Kompensimi i borxheve do të likujdohet nga institucionet buxhetore brenda buxhetit të tyre të miratuar nga parlamenti duke përdorur mekanizëm detyrimi.

15. *Cështjet që lidhen me Taksat*. Administrata Fiskale është një faktor i rëndësishëm lidhur me mbledhjen e borxheve dhe faturave aktuale nga konsumatorët privatë, meqënëse ata mund të kontrollojnë nëse të gjitha faturat e energjisë elektrike të përfshira në bilancin vjetor financiar të tyre janë likuiduar, duke shmangur mospagesën e detyrimit të energjisë, si një e mirë publike, dhe ndërkohë të zvogëlojnë fitimin dhe kështu me radhë të paguajnë më pak tatim mbi fitimin për aktivitetet e tyre.

VII. PLANI I VEPRIMIT PER ZBATIM

REFORMA NE SEKTORIN ENERGITIK/VEPRIMET QE DO TE NDERMEREN 2014-2018																			
D	Text1	Task Name	Duration	Start	Finish	2014		2015		2016		2017		2018		2019		1st	
						1st Half	2nd Half	1st Half	2nd Half	1st Half	2nd Half	1st Half	2nd Half	1st Half	2nd Half	1st Half	2nd Half		
						Qtr 1	Qtr 2	Qtr 3	Qtr 4	Qtr 1	Qtr 2	Qtr 3	Qtr 4	Qtr 1	Qtr 2	Qtr 3	Qtr 4	Qtr 1	
1	A	Masat Aktuale për Përmirësimin e performancës të Sektorit të Energjisë.	1484 days	Thu 4/24/14	Mon 12/30/19														
2	1	Përmirësimi i Arkëtimit të Faturave të Energjisë Elektrike dhe Zvogëlimi i Humbjeve	1360 days	Wed 10/15/14	Mon 12/30/19														
3	2	Ristrukturimi dhe Rregullimi i Tarifave	180 days	Thu 4/24/14	Wed 12/31/14														
4	3	Ristrukturimi i Overdraftit /Sigurimi i Garancive Qeveritare për Capex	210 days	Mon 3/16/15	Thu 12/31/15														
5	4	Fuqizimi i Strukturës Paguese ndërmjet Kompanive Energjitike dhe Institucioneve Shtetërore	83 days	Mon 11/17/14	Wed 3/11/15														
6	5	Hapja e ligarisë "Escrow" nga OSHEE	18 days	Mon 12/1/14	Wed 12/24/14														
7	B	Masa që ndërmeren vetëm njëherë	522 days	Thu 7/3/14	Thu 6/30/16														
8	1	Zerimi i detyrimeve të institucioneve Buxhetore dhe Jo-Buxhetore	188 days	Thu 1/15/15	Fri 10/2/15														
9	2	Reforma në Strukturën e Modelit të Tregut të Energjisë	382 days	Thu 1/15/15	Thu 6/30/16														
10	3	Pastrimi i Detyrimeve të Prapambetura ndaj PPE-ve përfshirë dhe PPE ASHTA	260 days	Thu 7/3/14	Tue 6/30/15														
11	C	Veprimet që duhet të Ndermeren për Implementimin e Planit Financiar të Rimëkëmbjes së Sektorit të Energjisë	1251 days	Mon 6/16/14	Fri 3/29/19														
12	C.1	Përmirësimi i Infrastrukturës së Shpërndarjes dhe Platformës së Tregut të Energjisë	1076 days	Mon 2/16/15	Fri 3/29/19														
13	1	Përmirësimi i Sistemit të Shpërndarjes dhe Transmetimit (transformimi dhe fuqizimi i dy nënstacioneve ekzistues 35 kV në 110 kV dhe ndërtimi i linjave përkatëse 110 kV	673 days	Mon 3/30/15	Tue 10/24/17														
14	2	Investime në, Furnizimi dhe Instalimi, në rrjetin e TM 6-20 kV (Linja Kablore dhe Ajrore TM, Linja TU, Linja ABC, Kablo koncentrik TU, shtylla betoni etj)	720 days	Tue 3/10/15	Fri 12/8/17														
15	3	Përmirësimi i Sistemit të Matjes në Rrjetin e Tensionit të Ulët	796 days	Sun 4/26/15	Fri 5/11/18														
16	4	Përmirësimi i Sistemit të Faturimit dhe Arkëtimit	566 days	Mon 2/16/15	Fri 4/14/17														
17	5	Investime në, matje për konsumatorët TM, Fiderat TM, PPE-të(për të gjithë klientët e lidhur në 20/10/6 kV dhe 35 kV)	1049 days	Wed 3/25/15	Fri 3/29/19														
18	6	Krijimi i një Qendre të re të Dhënash për konsumatorët TM dhe Sistemit IT	529 days	Mon 3/2/15	Wed 3/8/17														
19	7	Ngritja e një Platforme Tregu për PPE-të dhe konsumatorët e kualifikuar	899 days	Thu 4/16/15	Mon 9/24/18														
20	C.2	Mbështetja e Reformave në Sektorin e Energjisë	1168 days	Mon 6/16/14	Tue 12/4/18														
21	C.2.1	Reformat Ligjore Prioritare në Sektorin e Energjisë	1168 days	Mon 6/16/14	Tue 12/4/18														
22	1	Rishikimi i Modelit të Tregut të Energjisë	196 days	Thu 4/2/15	Wed 12/30/15														
23	2	Rishikimi i Ligjit për Energjinë e Rinovueshme	164 days	Thu 10/30/14	Mon 6/15/15														
24	3	Futja e një Metodologjie të Re të Ulogaritjes së Tarifave të mbulimit të kosteve (që reflektojnë përçueshmërinë e modelit të ri të Tregut të Energjisë)	220 days	Mon 3/2/15	Thu 12/31/15														
25	4	Përgatitja e Strategjisë Kombëtare të Energjisë	393 days	Mon 6/16/14	Tue 12/15/15														
26	5	Procedurat e reja për Kontratat e Shërbimit të Energjisë midis OST-KESH-OSHEE përfshirë dhe shërbimet ndihmëse	274 days	Wed 10/15/14	Fri 10/30/15														
27	6	Ligji i Ri i Sektorit të Energjisë	196 days	Tue 7/1/14	Tue 3/31/15														
28	7	Krijimi i Tregut të Dites në Avancë	926 days	Mon 2/16/15	Fri 8/31/18														
29	8	Liberalizimi i konsumatorëve të lidhur në rrjetin 20/10/6 kV	993 days	Mon 2/16/15	Tue 12/4/18														
30	9	Liberalizimi i konsumatorëve të lidhur në rrjetin 35kV	219 days	Sun 3/1/15	Wed 12/30/15														
31	10	Hartimi dhe Implementimi i Programit të Ndihmës Sociale për Konsumatorët e Energjisë Elektrike	340 days	Mon 2/16/15	Thu 6/2/16														
32	C.2.2	Përgatitja e Strategjisë dhe Mekanizmit të Zbutjes së Rrezikut për të adresuar paqëndrueshmërinë e motit	219 days	Mon 6/1/15	Thu 3/31/16														
33	1	Reduktimi i Nivëlit Potencial Financiar prej Kushteve Hidrologjike	219 days	Mon 6/1/15	Thu 3/31/16														
34	2	Vlerësimi i Sistemeve të Sigurisë së Riskut	219 days	Mon 6/1/15	Thu 3/31/16														
35	C.2.3	Faza Kërkkimore	1016 days	Mon 9/15/14	Fri 8/3/18														
36	1	Zgjidhja dhe Ri-Komisionimi i TEC-it të Vlorës	1013 days	Mon 9/15/14	Tue 7/31/18														
37	2	Identifikimi i Partnerëve për Ndërtimin e HEC-it të Skavicës	340 days	Mon 9/15/14	Thu 12/31/15														
38	3	Përgatitja e Marsterplanit Afatgjatë të OSHEE-së	329 days	Mon 6/15/15	Thu 9/15/16														
39	4	Transferimi i strukturës së FPSH-së tek OSHEE-ja	100 days	Fri 8/14/15	Thu 12/31/15														
40	5	Kontrata e Menaxhimit të OSHEE-së për periudhën 3-5 vjeçare	785 days	Mon 8/3/15	Fri 8/3/18														

Sektori i Energjitik Shqiptar (përfshirë OST)
Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave

(Lek/milionë)

	-----Parashikuar-----					
	Aktual					
	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Shitje OST-së (Për humbjet në transmetim)	161	268	254	254	254	254
Konsumatorët në Shitje me pakicë	37,080	42,250	42,340	45,479	49,097	49,050
Institucionet Buxhetore	5,362	6,735	7,226	7,741	8,177	8,634
Eksportet	257	11	2,646	1540	2,232	1,929
Përdoruesit Industriale	0	0	0	0	0	0
Shitjet e Energjisë	42,860	49,264	52,467	55,015	59,760	59,866
Të ardhura të tjera	3,730	943	944	944	944	944
Dëm ekonomik	0	0	0	0	0	0
Totali i të Ardhurave Operative	46,590	50,207	53,411	55,959	60,704	60,810
<i>Shpenzimet Operative:</i>						
Blerje Energjie nga Importi	20,779	14,690	13,571	11,112	9,307	7,535
Blerje Energjie nga Private&Koncesion	8,138	8,135	11,879	13,333	13,842	13,842
Blerje Energjie nga DSO						
Blerje Energjie nga WPS						
Blerje Energjie nga hidrocentrale të tjera	205	225	225	225	225	225
Blerja e energjisë nga familjarët	8,343	8,360	12,104	13,558	14,067	14,067
Personeli/ Pagat	4,454	5,913	5,963	6,016	6,073	6,133
Karburant	0	0	0	0	0	0
Mirëmbajtje	884	2,755	2,755	2,755	2,755	2,755
Blerje Materiale dhe Produktesh	549	522	522	522	522	522
Amortizimi	4,842	3,996	4,224	4,440	4,638	4,827
Furnizim dhe Shërbime - Tarifat E Transmisionit	4,215	4,344	4,114	4,126	4,228	4,106
- Sigurimit						
- Të tjera	754	825	825	825	825	825
Furnizim dhe Shërbime - Të tjera	4,969	5,169	4,939	4,951	5,053	4,931
Aktive te vetëndërtuara	0	0	0	0	0	0
Rezerva per borxhet e këqija	5,804	6,858	5,948	5,322	4,582	3,461
Shpenzime të tjera	1,659	779	779	779	779	779
Totali i Shpenzimeve Operative	52,283	49,042	50,806	49,455	47,776	45,010
Rezultati Operativ Bruto	(5,693)	1,165	2,605	6,503	12,928	15,800
EBITA	(851)	5,161	6,829	10,943	17,566	20,627
<i>Të Ardhurat Financiare:</i>						
Të Ardhurat nga Interesi	580	279	422	441	420	417

Fitim nga Kursi i Këmbimit	0	205	0	0	0	0
Të ardhura të tjera financiare dhe jo-financiare	0	308	0	0	0	0
Totali i të Ardhurave Financiare	580	792	422	441	420	417
<i>Shpenzimet Financiare:</i>						
<i>Pagesat e Interesit - KESH</i>	1,838	1,410	955	839	719	601
- IFC/EBRD	0	0	0	0	0	0
-World Bank	0	0	20	59	94	111
-Overdraft	1,819	1,776	2,507	2,841	3,030	2,909
Pagesat e Interesit	3,657	3,186	3,482	3,739	3,843	3,621
Humbjet nga kursi i këmbimit	0	0	0	0	0	0
Shpenzime të tjera financiare dhe jo-financiare	273	409	318	216	110	0
Totali i Shpenzimeve Financiare	3,930	3,595	3,800	3,954	3,953	3,621
Shpenzimet Financiare Neto	(3,350)	(2,803)	(3,378)	(3,513)	(3,533)	(3,205)
Fitimi para taksave dhe shpenzimeve të paparashikuara	(9,043)	(1,638)	(772)	2,990	9,395	12,595
Të Ardhura/(Shpenzime) te paparashikuara	(1,642)	4,763	0	0	0	0
Fitimi para Taksave	(10,685)	3,125	(772)	2,990	9,395	12,595
Tatimi mbi Fitimin	2,324	1,378	1,895	1,988	3,101	4,028
Fitimi i Vitit	(13,009)	1,747	(2,668)	1,002	6,293	8,567
Dividenti (10%)	0	0	0	0	0	0
Fitimi Neto I Shpërndarë	(13,009)	1,747	(2,668)	1,002	6,293	8,567

Sektori i Energjitik Shqiptar (përjashtuar OST)ⁱ
Pasqyra e konsoliduar e lëvizjes së Fluksit të Parasë

(Lek/milionë)

	Aktual	-----Parashikuar-----				
	2014	2015	2016	2017	2018	2019
A. Aktivitetet Operative:						
Fitim/(humbja) e vitit	(13,009)	1,541	(2,668)	1,002	6,293	8,567
Amortizimi	4,842	3,996	4,224	4,440	4,638	4,826
Amortizimi i granteve	0	0	0	0	0	0
Rezerva per borxhet e këqija	7,080	6,858	5,948	5,322	4,582	3,461
Të tjera jo monetare	0	0	0	0	0	0
Fluksi i Parasë i gjeneruar nga Aktiviteti Operativ	(1,087)	12,395	7,505	10,764	15,513	16,854
Rregullime per:						
(Rritje)/Pakësim i gjendjes së inventarit	569	587	11	0	0	0
Buxhetore, jo buxhetore dhe eksporte	5,000	4,236	(211)	88	(55)	24
Konsumatorët per shitjet me pakicë	(14,707)	1409	-6443	(5,744)	(5,084)	(4,089)
OST	0	0	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) i Debitoreve për Energjinë	(9,707)	5,645	(6,653)	(5,656)	(5,140)	(4,064)
Rritje/(Pakësim) i Parapagesave	0	4	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) i Detyrimeve të Shtetit	0	0	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) i Debitoreve të Tjerë	(610)	0	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) e Pagueshme ndaj Furnitorëve	(280)	(226)	1	(1,911)	(134)	(134)
Rritje/(Pakësim) në Detyrimet për Energjinë - WPS	(4,192)	(6,182)	0	0	0	0
-	-	-	-	-	-	-
Importet	171	1,381	(105)	(231)	(170)	(167)
-	-	-	-	-	-	-
Tjetër	10,794	(2,550)	(2,646)	(2,747)	(2,851)	0
Rritje/(Pakësim) në tarifat e transmetimit të pagueshme	1,455	0	(409)	(823)	(1,263)	(1,637)
Rritje/(Pakësim) i diferencave nga kursi këmbimit	0	0	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) në taksat e pagueshme	0	(1,040)	191	0	400	621
Rritje/(Pakësim) në detyrimet ndaj personelit	0	17	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) në detyrimet afatshkurtra ndaj shtetit	2,825	(9,000)	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) në detyrimet e prapambetura	0	0	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) në rezerva	0	0	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) në detyrimet afatshkurtra	10,772	(17,600)	(2,969)	(5,711)	(4,018)	(1,317)
Fluksi i Parasë Neto i gjeneruar nga Aktiviteti Operativ	(62)	1,031	(2,107)	(603)	6,355	11,473

B. Aktivitetet e Investimeve:	0	0	0	0	0	0
Rritje/ (Pakësim) në investimet financiare	375	1,530	1,522	1,514	1,514	1,061
Rritje/(Pakësim) në aktivet e paprekëshme	0	0	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) në aktivet e tjera	0	0	0	0	0	0
Blerje e aseteve fikse (-)	(5,779)	(5,612)	(5,339)	(4,950)	(4,628)	(4,268)
Shitjet e aseteve fikse dhe nxjerrja e tyre jashtë përdorimit	0	0	0	0	0	0
	0	0	0	0	0	0
C. Fluksi i parasë i përdorur për investime	(5,404)	(4,082)	(3,817)	(3,436)	(3,114)	(3,207)
Aktiviteti financiar:						
Rritje në kreditë e marra ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare	3,077	0	5,446	4,941	3,778	0
Pagesa Principali	(4,481)	(5,876)	(4,733)	(4,577)	(3,994)	(3,567)
Të Tjera	0	0	0	0	0	0
Pagesa Dividenti	(1,270)	0	0	0	0	0
Kapitali Ulje/Rritje	0	0	0	0	0	0
Fluksi i Parasë nga Aktiviteti Financiar	(2,674)	(5,876)	713	364	(215)	(3,567)
Bilanci i Fluksit të Parasë të Periudhës	(8,140)	(8,928)	(5,210)	(3,676)	3,026	4,699
Gjendja e Parasë në Fillim të Periudhës	(39,862)	(32,911)	(41,839)	(47,049)	(50,724)	(47,699)
Gjendja e Parasë në Fund të Periudhës	(32,911)	(41,839)	(47,049)	(50,724)	(47,699)	(43,000)
	(48,002)					

Sektori i Energjitik Shqiptar (përjashtuar OST)

Bilanci i Konsoliduar

(Lek/milionë)

	Aktual	Parashikuar				
	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Aktivitet						
Aktive të Qëndrueshme						
Ndërtesa, Impiante dhe Pajisje	142,192	146,555	152,167	157,505	162,456	167,083
Investime në Proces	4,362	5,612	5,339	4,950	4,628	4,268
Amortizimi i akumuluar	42,866	46,862	51,087	55,527	60,164	64,991
Llogari te Arkëtueshme Financiare	0	0	0	0	0	0
Aktive Fikse Neto	103,689	105,305	106,419	106,929	106,919	106,360
Aktive të PaTrupëzuara	163	163	163	163	163	163
Investime Financiare	11,937	10,408	8,886	7,372	5,858	4,798
Aktive të tjera	0	0	0	0	0	0
Totali i Aktiveve jo-Qarkulluese	115,789	115,875	115,467	114,464	112,940	111,321
Aktive Qarkulluese						
Inventari	2,820	2,232	2,221	2,221	2,221	2,221
<i>Energji - Institucionet buxhetore</i>	4,237	0	0	0	0	0
- Eksporti	0	1	212	123	179	154
- Konsumatorët me Pakicë	69,513	68,104	74,547	80,291	85,376	89,464
- OSHEE	40,668	40,668	40,668	40,668	40,668	40,668
- OSHEE	0	0	0	0	0	0
- OST	564	564	564	564	564	564
- Tjetër	5,734	5,734	5,734	5,734	5,734	5,734
Debitorët	120,716	115,071	121,725	127,381	132,520	136,585
Rezervat për borxhet e këqija	(87,395)	(94,253)	(100,201)	(105,523)	(110,105)	(113,566)
Parapagesa	(4)	(8)	(8)	(8)	(8)	(8)
Shteti	2,286	0	0	0	0	0
Arka dhe Banka	324	1,387	0	0	0	2,821
Diferenca nga Kursi Këmbimit	0	0	0	0	0	0
Totali i Aktiveve Qarkulluese	38,747	24,430	23,737	24,071	24,628	28,052
	0	0	0	0	0	0
Totali i Aktiveve	154,536	140,305	139,204	138,534	137,569	139,373

DETYRIMET DHE KAPITALI I VET

Kapitali i Vet

Kapital i Nënshkruar	50,139	50,139	50,139	50,139	50,139	50,139
Kapitali i Rregjistruar i Papaguar	(4)	(4)	(4)	(4)	(4)	(4)
Rezerva e Rivlerësimit	46,493	46,493	46,493	46,493	46,493	46,493
Rezervat	7,533	7,533	7,533	7,533	7,533	7,533

Fitime të mbartura/(Humbje të mbartura)	(90,470)	(103,479)	(101,937)	(104,605)	(103,603)	(97,310)
Fitimi/(Humbja) e Vitit	(13,009)	1,541	(2,668)	1,002	6,293	8,567
Totali i Kapitalit të Vet	683	2,224	(444)	558	6,852	15,418

Detyrime afatgjata

Kreditë	35,534	30,873	31,815	33,125	33,336	30,526
Grante Qeveritare	143	143	143	143	143	143
Të Tjera	1,424	1,424	1,424	1,424	1,424	1,424
Totali i detyrimeve afatgjata	37,100	32,440	33,381	34,692	34,903	32,093

Detyrime afatshkurtra

Kreditë	6,750	5,534	5,306	4,360	3,933	3,176
Overdraft	35,520	43,226	47,049	50,725	47,699	45,821
<i>Furnitore (Materiale dhe shërbime)</i>	2,617	2,391	2,392	481	347	212
<i>Blerjet e Energjisë - WPS</i>	0	0	0	0	0	0
- IPPs	6,182	0	0	0	0	0
- Vlorë	0	1,381	1,276	1,045	875	708
- Importeve	0	0	0	0	0	0
- Të Tjera	0	0	0	0	0	0
Blerjet e Energjisë	6,182	1,381	1,276	1,045	875	708
OSHEE Sh.a	10,794	8,244	5,598	2,851	0	0
Tarifat e Transmetimit	9,065	9,065	8,656	7,833	6,569	4,933
Taksat e Pagueshme	10,324	9,284	9,475	9,475	9,875	10,496
Personeli	34	51	51	51	51	51
Shteti	17,525	8,525	8,525	8,525	8,525	8,525
Shpenzimet e Përlllogaritura	9,275	9,275	9,275	9,275	9,275	9,275
Rezervat	8,667	8,667	8,667	8,667	8,667	8,667
<i>Totali i llogarive të pagueshme</i>	74,482	56,882	53,913	48,202	44,183	42,866
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra	116,752	105,642	106,268	103,286	95,816	91,864
Totali i Detyrimeve	153,853	138,083	139,649	137,978	130,719	123,957
Totali i Detyrimeve dhe i Kapitalit të Vet	154,536	140,307	139,206	138,536	137,570	139,375

Raportet Financiare

Marzhi i Fitimit (%)	-27.9%	3.1%	-5.0%	1.8%	10.4%	14.1%
Raporti i mbulimit të Borxhit		0.1	0.1	0.2	0.3	0.4
Borxhi / Raporti Total i Kapitalizimit(%)	24.0%	23.1%	24.0%	25.0%	25.4%	23.0%

¹ Këto shifra do të jenë subjekt i ndryshimeve në varësi të rezultateve të auditimit vjetor.